



Ftesë për Programin Svit

Të nderuar,

Ju ftojmë përzemërsisht të merrni pjesë në Programin Svit, programin kombëtar për depistimin dhe zbulimin e hershëm të ndryshimeve parakanceroze dhe të kancerit të zorrës së trashë dhe të rektumit.

Programi realizohet që nga viti 2009 me përkrahjen e Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Sllovenisë. Bartësi i Programit është Instituti Kombëtar për Shendetin Publik. Programi u kushtohet meshkujve dhe femrave nga 50 deri 74 vjeç, ndërsa qëllimi i tij është zbulimi i hershëm i ndryshimeve parakanceroze dhe formave të hershme të kancerit të zorrës së trashë dhe të rektumit edhe tek njerëzit që ndjehen mirë dhe që nuk kanë probleme.

Pjesëmarrja në Programin Svit çdo dy vjet ju mundëson kontrollin profesional parandalues të mostrave të feçes për gjak të fshehur. Në rast se vërehet prania e gjakut, do të dërgoheni të bëni kolonoskopinë e cila do të shpjegojë shkakun e gjakut. Kjo do të thotë që me testim të rregullt të feçes për gjak të fshehur do të mund të parandaloni zhvillimin e kancerit, ose ta zbuloni mjaft herët atë, në mënyrë që mjekimi të jetë mjaft i suksesshëm.

Programi Svit ka treguar vitet e kaluara se është efikas dhe shumë personave u ka përmirësuar shëndetin dhe u ka shpëtuar jetën. Rëndësi ka që shumicën e rasteve të kancerit e kemi zbuluar mjaft herët, kështu që mjekimi onkologjik nuk ka qenë i nevojshëm, ndërsa me zbulimin dhe mënjanimin në kohën e duhur të ndryshimeve parakanceroze kemi ndaluar zhvillimin e sëmundjes te shumë njerëz.

Me pjesëmarrjen në Programin Svit, nuk do të keni shpenzime, sepse ato i mbulon sigurimi juaj i domosdoshëm shëndetësor.

SI TË MERRNI PJESË NË PROGRAMIN SVIT

Në Programin Svit do të përfshihen kur **t'i plotësoni të dyja faqet dhe të nënshkruani Deklaratën** bashkangjitur për **pjesëmarrjen me dëshirë në Programin Svit**. Ju lutemi të na e dërgoni atë **brenda një afati sa më të shkurtë**. Bashkangjitur është zarfi me taksën postale të paguar.

Ju do ta merrni ftesën çdo dy vjet, derisa të mbushni moshën 74 vjeç. Për pjesëmarrje në Programin Svit **çdo herë duhet të plotësohet, nënshkruhet dhe dërgohet** Deklarata për pjesëmarrjen me dëshirë në Programin Svit, sepse na nevojiten përsëri të dhënat dhe aprovimi juaj.

Nëse plotësoni kriteret për pjesëmarrje në programin për depistim, një javë pas mbërritjes së Deklaratës suaj të nënshkruar për bashkëpunimin me dëshirë në Programin Svit, do t'ju dërgojmë një komplet për marrjen e dy mostrave të feçes me udhëzime të detajuara. Marrjen e mostrave të feçes e bëni vetë në shtëpi, kurse mostrat na i dërgoni në Qendrën Svit. Në laboratorin e Programit Svit të dyja mostrat e feçes do të analizohen për gjak të fshehur dhe, pas një jave, do t'ju informojmë për rezultatet e kontrollit.

Ju mund të mësoni më shumë për Programin Svit nga broshura bashkangjitur, kurse për informacione shtesë mund të:

- kontaktoni çdo ditë midis orës 9.00 dhe 14.00 Qendrën e kontaktit të Programit Svit në numrin e telefonit 01 620 45 21;
- shkruani në adresën: Program Svit, p. p. 241, 1001 Ljubljana ose në svit@nijz.si, respektivisht të dërgoni faks në numrin 01 620 45 29;
- vizitoni faqen internet të Programit Svit www.program-svit.si;
- vizitoni Pikën e kontaktit të Svit-it në Qendrën e parandalimit të kësaj Shtëpie të shëndetit ose të
- vizitoni mjekun tuaj të zgjedhur personal.

Shfrytëzoni mundësinë e kontrollit parandalues dhe merrni pjesë në Programin Svit. Shumë persona kanë përmirësuar kështu tashmë shëndetin e tyre dhe i kanë shpëtuar jetën vetes – një prej tyre mund të jeni edhe ju.

Duke u kujdesur për shëndetin tuaj, ju përshëndesim përzemërsisht.

Jožica Maučec Zakotnik, dr. med., spec.,
Kryetar i Programit Svit me bashkëpunëtorët